



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4761 Prot.

Ballsh, më 29.09.2022

VENDIM

Nr. 51 Datë 28.09.2022

PËR

**MIRATIMIN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR
NXËNËSIT PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 01, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit për vitin 2022" Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 58, datë 20.12.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër nr. 12, datë 24.02.2020, "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Mallakastër", si dhe konstatimet e kryera mbi vështirësitë e lëvizjes në akset rrugore të mëposhtme dhe për të garantuar mundësinë që fëmijët/nxënësit e këtyre shkollave të zhvillojnë proces normal mësimor,

VENDOSI

1. Kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën 100 (njëqind) lekë / nxënës për cdo ditë për vitin shkollor 2022-2023, në linjat e mëposhtme:

- *Selitë - Shkolla 9 – vjeçare Fratar*
- *Çërrilë - Shkolla 9 – vjeçare Gjerbës*
- *Rripan - Shkolla 9 – vjeçare Ngraçan*
- *Ngraçie - Shkolla 9 – vjeçare Visokë*
- *Belishovë - Shkolla 9 – vjeçare Visokë*
- *Gadurovë - Shkolla 9 – vjeçare Ninësh*
- *Ramaj - Shkolla 9 – vjeçare Ninësh*

2. Shpenzimet do të mbulohen nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, artikulli 602.

KRYETAR

FITIM BARAJ

